



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 5.11.2021, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Nasip Naço – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile lidhur me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”.

Marrin pjesë:

Nasip Naço, Ferdinand Xhaferraj, Xhemal Qefalia, Antoneta Dhima, Toni Gogu, Bardhyl Kollçaku, Vullnet Sinaj, Denis Deliu, Luan Duzha, Ilirian Pendavinji, Isuf Celaj, Luan Baci, Lindita Metaliaj dhe Ervin Salianji.

Mungojnë:

Agron Çela, Paulin Sterkaj, Flamur Noka, Enkelejd Alibeaj, Kasem Mahmutaj dhe Pranvera Resulaj.

Të ftuar:

Haki Cako – Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile
Robert Hysenllari - Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Përgjigjes Emergjent të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile
Përparim Kadiu – Shef i Sektorit të Financës i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile
Mimoza Dhëmbi – Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave
Nasip Naço – Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, seancë dëgjimore me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile lidhur me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”.

Nga Agjencia janë të pranishëm: zoti Haki Çako, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile; zoti Robert Hysenllari, drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Përgjigjes Emergjent të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile; zoti Përparim Kadiu, shef i Sektorit të Financës në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, si dhe zonja Mimoza Dhëmbi, drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Fjala për ju, zoti Drejtor.

Haki Çako – Faleminderit!

I nderuar kryetar i Komisionit të Sigurisë,

Të nderuar deputetë,

Në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2022 të parashikuar për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, ju informoj dhe vlerësoj si më poshtë vijon:

Misioni, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile përcaktohen e rregullohen në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe të akteve të tjera nënligjore, në të cilat përcaktohet se mbrojtja civile synon krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë dhe për t’u rimëkëmbur nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Me fondet e miratuara për vitin 2021 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2022 realizohen objektivat si:

Sigurimi i logjistikes së nevojshme, si dhe mbështetja e operacioneve të emergjencave civile.

Zvogëlimi i humbjeve në jetë njerëzish dhe lehtësimi i pasojave të fatkeqësive në pronën, trashëgimisë kulturore, në mjedis e të tjera.

Treguesit e performancës në përmbushje të këtyre objektivave janë:

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë, parandalimin e risqeve të reja, zvogëlimi e atyre ekzistuese, menaxhimi i riskut të mbetur, duke forcuar aftësitë ripërtëritëse për arritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.

Jetë të shpëtuarra dhe familje të kompensuara.

Infrastrukturë dhe mjedis i mbrojtur nga faktorë shkatërrues natyrorë.

Zhvillimi i kapaciteteve të ndërsjella rajonale për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore, si një nevojë e përgjigjes së përbashkët dhe të integruar, mbështetur nga BE-ja nëpërmjet financimit të një sërë projektesh të përbashkëta.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i sistemit të mbrojtjes civile në nivel qendror dhe vendor për menaxhimin e emergjencave civile, në garantim të resurseve financiare dhe njerëzore, për një përgjigje të menjëhershme dhe profesionale për fatkeqësitë që mund të prekin territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në kuadër të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”, të udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, VKM-ja nr. 577/2020 ”Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve për PBA-në 2022-2024”, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile përgatiti kërkesat buxhetore të vitit 2022-2024. Tavanet buxhetore për vitin 2022 janë si më poshtë:

- Paga dhe sigurime (600-601) 117,000
- Shpenzime korrente të tjera (602-606) 190,000
- Kapitale të brendshme (230-232) 810,000
- Kapitale të huaja (230-232) 400,000
- Shpenzime jashtëbuxhetore
- Totali 1,517,000

Kategoritë e parashikuara për të cilat janë hartuar kërkesat buxhetore janë:

1. Përballimi i shpenzimeve gjatë zhvillimit të aktivitetit ekonomik dhe financiar.
2. Përballimi i shpenzimeve për situata të fatkeqësive natyrore, si: për blerje karburanti; për furnizime dhe shërbime; riparim e mirëmbajtje.
3. Përballimi i shpenzimeve për pjesëmarrjen e personelit në udhëtime brenda dhe jashtë vendit e të tjera.
4. Mbështetja me mallra e shërbime dhe mbështetja administrative.
5. Përballimi i shpenzimeve për investime.

Në përcaktimin e kërkesave buxhetore u jemi referuar politikave buxhetore të parashikuara në programin buxhetor afatmesëm 2022-2024, limiteve të shpenzimeve të përcaktuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, kërkesave dhe nevojave të strukturës sonë, realizimit të shpenzimeve buxhetore të vitit 2020 dhe realizimit të pritshëm të vitit 2021.

Krahasuar me buxhetin e miratuar me ligjin nr. 137/2020, datë 16.12.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, rezulton se në total projektbuxheti i vitit 2022 është në rritje në masën 53%, ku sipas artikujve, në artikullin “Paga e sigurime” dhe “Mallra e shërbime” nuk ka rritje, ndërsa në artikullin “Transferta korrente të brendshme (shpenzime për përbalimin e fatkeqësive natyrore) rritja është në masën 13,9% në “Shpenzime kapitale të trupëzuara” (investime nga buxheti) rritja është në masën rreth 2 herë, ndërsa në investimet e huaja rritja është në masën 33%. Sqarojmë se plotësimi i pritshëm i organikave në fund të vitit 2021 do të jenë në masën 85% dhe për vitit 2022 është parashikuar plotësimi i tyre në masën 100%.

Nisur nga detyrimet për likuidimin e fatkeqësive natyrore që i përkasin tërmetit të shtatorit të vitit 2019 dhe tërmetit të nëntorit të vitit 2019 (për bashkitë për të cilat nuk është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore) dhe të fatkeqësive nga përmbytjet dhe zjarret, ku deri në fund të vitit 2021 mbeten pa likuiduar shuma prej 772 milionë lekë dhe në PBA-në e vitit 2022, është parashikuar shuma prej 131 milionë lekë, kërkohet rishikimi i kësaj shume, me qëllim akordimin e fondeve për të përballuar shpenzimet e kësaj natyre.

Në zërin investime (buxheti i shtetit) për vitin 2021 janë planifikuar për financim 810 milionë lekë, ku në analize janë si më poshtë:

- Pagesë TVSH-je për projektin me financim të huaj “To be ready “ dhe projekti me financim të huaj *fire prep*, pagesë TVSH-je dhe bashkëfinancim (Improved Forest Fire PRE Parednessin Greece and Albania) FIRE PREP” 31,485,000 lekë.

- Fatkeqësi natyrore të menaxhuara - 766,059,000 lekë.
- Ndërtimi i stacioneve hidrometeorologjike - 12,456,000 lekë.

Në totalin e projektit fatkeqësi të menaxhuara përfshihen:

- Ndërtim argjinature lumore Shkodër, Lezhë, Fier dhe Vlorë.
- Ndërtim pritash në lumenj, si bashkitë: Shkodër, Kurbin, Mirditë, Berat dhe Dimal.
- Riparim diga, shkarkuesi kataskrofik, portave lëshuese të ujëmbledhësve.
- Riparim dhe ndërtim urash për bashkitë Klos dhe Lezhë.

Me këto investime sigurohet lehtësimi i pasojave dhe parandalimi nga fatkeqësitë e përmbytjes, mbrojtjen e komunitetit, pronës dhe gjësë së gjallë. Sigurimi i lëvizjes dhe aktivitetit ekonomik të banorëve të këtyre zonave.

Ndërsa për investimet për stacionet meteorologjike janë parashikuar, ndërtimi i stacioneve meteorologjike në Tepelenë, Vlorë, Durrës, Shkodër, Tiranë dhe Fier, të cilët do të bëjnë të mundur rritjen e kapaciteteve për marrjen e informacionit në kohë reale për motin dhe nivelin e ujërave në lumenj, me qëllim lajmërimin e hershëm të popullsisë dhe marrjen e masave të strukturave të mbrojtjes civile në zonat e fatkeqësisë.

Në kuadër të parashikimit në PBA-së të fondit për investimet e huaja, ju bëjmë me dije se projektet që janë në zbatim në AKMC-ja për të cilat raportojmë janë:

1. FIRE PREP/IPA CBC Greqi-Shqipëri

Kontributi i BE-së në projekt - 284,039,40 euro

Bashkëfinancimi - 50,124,60 euro

TVSH-ja - 66,832.8 euro

2. *To be ready*/IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi

Buxheti total *To be ready* - 1,479,049,95 euro

Financimi IPA II - 1,257,192,45 euro

Bashkëfinancimi AKMC - 221, 857,50 euro

Vlera totale për blerje dhe shërbime - 944,250 euro

Vlera e TVSH-së për 2022 - 188,850,00 euro

3. Programi i pronës

Buxheti total – 2,2 milionë euro

Detyrim i AKMC-së është pagesa e TVSH-së.

Ndërkohë që AKMC-ja është një strukturë e re e sapokrijuar dhe ka në proces shumë projekte dhe iniciativa të tjera, ku është e përfshirë dhe ka aplikuar për të cilat do të nevojitet shpenzimi i disa fondeve nga buxheti, siç janë:

Fondet financiare të parashikuara në PBA në artikullin e investimeve të huaja janë shumë të nevojshme dhe do të përdoren si pjesë e bashkëfinancimit, financimit apo pagesë TVSH-je në projekte të ndryshme me financim të huaj dhe bashkëfinancim nga AKMC, specifikisht si më poshtë:

1. Projekte për rehabilitimin dhe forcimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm, që mund të konsistojnë në rehabilitimin e stacioneve të mbetura nga pronë apo stacione të reja, që do të përmirësojnë cilësinë e parashikimit të motit dhe përmytjeve në vendin tone. Gjithashtu, me JICA japoneze pritet një projekt për forcimin e sistemit të lajmërimit të hershëm.

2. Projekte në kuadër të angazhimit në kuadër të IPA WATER 2022, e cila synon implementimin e direktivës së përmblyes
3. Projekte që do të konsistojnë në rritjen e standardeve teknike, administrative, institucionale të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, por edhe të gjithë sistemit të mbrojtjes civile në Shqipëri.
4. Projekt me financim të qeverisë italiane, që ka si qëllim rritjen e kapaciteteve të shërbimit zjarrfikës, ndërtimin e Qendrës Kombëtare Operacionale dhe ndërtimin e godinës së re të AKMC-së. Ky projekt ka, gjithashtu, si qëllim ndërtimin e 4 godinave dhe infrastrukturën për 4 qendrat e mbrojtjes civile në të 4 qarqet.
5. Projektet dhe aktivitetet në kuadër të programit IPA “Fire and Floods”, i cili po implementohet aktualisht dhe ka si koordinator kombëtar AKMC-në.
6. Projekte në kuadër të IPA III, që do të fillojnë së shpejti, ku AKMC-ja është e përfshirë në të gjitha dimensionet që synojnë forcimin e sistemit të mbrojtjes civile.
7. Projekte për forcimin e kapaciteteve të institucioneve teknike si IGJEUM, i cili do të ndihmojë në forcimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm.
8. Projekt për implementimin e sistemit 112, si dhe sistemeve të tjera të monitorimit dhe alarmit, i cili është përfshirë edhe në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian/PKIE.
9. Projekt për ndërtimin e Qendrës Kombëtare të Trajnimeve për të gjitha institucionet dhe strukturat operacionale të sistemit të Mbrojtjes Civile Shqiptare.
10. Projekte dhe hartimi i moduleve për rritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e forcave operacionale që funksionojnë në Shqipëri.
11. Projekte që do të dalin nga plani i veprimit dhe investimeve në kuadër të hartimit të strategjisë së reduktimit të riskut dhe vlerësimit të riskut si detyrime të ligjit nr. 45/2019.
12. Projekte në kuadër të programit “HORIZONT 2021-2022” bazuar planit të punës ku disa projekte, në të cilat AKMC-ja ka marrë dhe do të marrë pjesë kryesisht në fushën e kërkimit shkencor dhe investimeve konkrete.
13. Projekte dhe zhvillime të rëndësishme që kanë rrjedhur pas PDNA “Post disaster Needs Assessment” pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019.
14. Gjithashtu, në kuadër të IPA CBC me Itali, Mali i Zi - Shqipëri, Maqedoni e Veriut - Shqipëri dhe Greqi - Shqipëri priten thirrje të reja, në të cilat AKMC-ja do të marrë pjesë.

Pra, nisur nga sa më sipër, pritshmëria për një buxhet të konsiderueshëm në investimet e huaja është shumë e madhe, nisur edhe nga zhvillimit ligjore të ndodhura, që do të sjellin zhvillime rrënjësore në funksionin e sistemit, ku investimet e huaja janë shumë të rëndësishme nisur edhe nga fokusi i madh që ka marrë kjo fushë pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, por edhe situatës së COVID-19, por edhe në kuadër të anëtarësimit në BE dhe anëtarësimit në mekanizmin e mbrojtjes civile evropiane.

Faleminderit

Nasip Naço – Faleminderit!

Fjala për zotin Duzha. Në mënyrë të përmbledhur, ju lutem, që të mos kalojmë në përsëritje.

Më pas, fjala për zotin Xhaferraj.

Luan Duzha - Faleminderit, zoti drejtor, për të gjithë ekspozenë që bëtë për projektbuxhetin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile!

Ishit shumë shterues, kështu që, edhe unë nuk kam pse zgjatem. Doja të theksoja se ky është një buxhet krahasuar me atë të vitit 2021 në masën 53% në rritje, që është një gjë shumë e mirë për ta theksuar.

Një fakt tjetër është se më vjen mirë që jeni pjesë e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes, ky është një fakt që ju bën të mundur të thithni sa më shumë fonde dhe t'i përdorni për të arritur objektivat që ju keni gjithmonë në shërbim të njerëzve.

Të mos zgjatem kisha dy pyetje: si është bashkëpunimi juaj me pushtetin vendor për menaxhimin e emergjencave civile nëpërmjet garantimit të resurseve financiare dhe njerëzore për këtë qëllim, si një kërkesë në rritje për vendin tonë, tashmë kaq të prekur nga këto fenomene? Kam parasysh këtu edhe atë fondin 4%, që është vendosur në ligj. Çfarë bëhet me këtë fond për sa u përket bashkive?

Pyetjen e dytë e kam për Ministrinë e Financave, detyrimi i prapambetur që keni ju, me sa di unë, është që në vitin 2009 detyrimet që keni në ngarkim janë rreth 772 milionë lekë, dhe janë akorduar rreth 131 milionë lekë. A ka mundësi Ministria e Financave (këtu kërkoj dhe miratimin dhe mbështetjen e kolegëve) që ta rrisim këtë fond, mundësisht të barazohet, që drejtorja juaj të jetë e aftë t'i shlyejë këto njëherë e mirë, pasi, siç thashë, që nga viti 2009 janë goxha vite që ngelen?

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Duzha!

Zoti Çako.

Haki Çako – Faleminderit, për pyetjen!

Së pari, në lidhje me bashkëpunimin me pushtetin vendor për investimin, menaxhimin dhe rehabilitimin e situatave të fatkeqësive natyrore, më duhet t'ju informoj se bashkëpunimi i AKMC-së me të gjitha bashkitë në nivel kombëtar është i shkëlqyer. Ne kemi qenë pjesë e koordinimit, bashkëpunimit dhe bashkëveprimit midis njësive të pushtetit vendor, në mënyrë të veçantë të bashkive, të cilat kanë pasur situata të jashtëzakonshme lidhur me emergjencat civile, i koordinimit me institucionet e tjera, si Ministria e Mbrojtjes me strukturat operationale qendrore, të cilat kanë qenë prezent në mbështetje të nevojave që kanë pasur bashkitë. Pothuajse me të gjitha bashkitë ne jemi në bashkëpunim dhe një bashkërendim të vazhduar dhe ata tashmë janë në referencë në zbatim të ligjit nr. 45 “Për mbrojtjen civile”, por edhe të ligjit për pushtetin vendor. Përqindja e përcaktuar në ligjin nr. 45 për buxhetin e kushtëzuar 4% tashmë është bërë e qartë pothuajse në të gjitha njësitë, por sigurisht tërësia e buxhetit të akorduar në AKMC, por edhe në investime në total e kalon vlerën e 4%. Gjithsesi, kjo mbetet ende për t'u konsoliduar, pasi një pjesë e konsiderueshme e bashkive nuk kanë qenë realisht të impenjuara për ta interpretuar apo për ta shfrytëzuar këtë në maksimum. Në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Financave jemi duke punuar intensivisht për të arritur në momentin e implementimit të ligjit për 4%, ashtu sikurse edhe për të gjitha institucionet dhe ministrinë e tjera, në referencë të ligjit, 2-4% për buxhetin e çështjeve të mbrojtjes civile në investim për parandalimin, menaxhimin, por edhe për rehabilitimin e fatkeqësive natyrore.

Në lidhje me detyrimin e mbartur, është e vërtetë, sikurse e thashë edhe pak më parë, AKMC-ja mbart një detyrim prej 7,7 milionë për kompensimin e qytetarëve, të cilët janë dëmtuar ndër vite nga fatkeqësitë natyrore. Ne jemi duke punuar dhe e kemi në program 131 milionë në buxhetin e AKMC-së, për vitin 2022 është planifikuar që të kompensojë një pjesë të konsiderueshme të vlerës. Sipas përqindjes së përlllogaritur është një çështje që do të vazhdojë të jetë në objeksionin tonë, kuptohet që asnjë buxhet nuk mund të mbulojë në mënyrë të menjëhershme kompensime të tilla, pasi ka edhe një problematikë që lidhet drejtpërdrejtë me detyrën që ka AKMC-ja. Ne jemi duke punuar me inspektim dhe verifikim të të gjitha dosjeve të mbartura, pasi një pjesë e tyre, për hir të së vërtetës, janë të pasakta për të mos thënë që ka edhe dosje, të cilat janë abuzive. Një pjesë e vlerësimeve nuk korrespondojnë me preventivët dhe me situatat, ndaj edhe diferenca mund të mos jetë saktësisht kjo.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Çako!

Zoti Xhaferraj.

Ferdinant Xhaferraj – Faleminderit, kryetar!

Zoti drejtor i Emergjencave, e dëgjova fjalën tuaj dhe do të doja të dija për saktësi, me sa më kujtohet, ju jeni emëruar drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave një javë para tërmetit të 26 nëntorit. Jam korrekt?

(Ndërhyrje ma mikrofon)

Kjo nuk do të thotë se e ka sjellë tërmetin zoti Çako!

Gjatë asaj fatkeqësie që përjetuan qytetarët e Durrësit dhe disa qytete të tjera, do të thotë që doli lakuriq fytyra e shtetit shqiptar, një shtet i përbërë nga zyrtarë që vraponin pas luksit. Pse e them këtë? Në qoftë se gjatë ditëve të tërmetit (drejtorit i kujtohet shumë mirë, pasi ka qenë edhe drejtor i Përgjithshëm i Policisë) pamë punonjës të emergjencave pa kapele, pa uniforma, pa pajisje, që na bënë me turp të gjithëve kur kthenin kokën, në mjerim, kush ka një sqepar e kush ka një çekiç, dhe, nga ana tjetër, po në javën e parë të dhjetorit, pamë drejtorët e policisë së qarqeve, që shkonin në sheshin “Nënë Tereza” dhe merrnin çelësat e “Rang Rover”-ve të bardhë, sepse shteti shqiptar kishte kërkuar nga BE-ja makina të tilla, policia më e varfër në Europë që kërkon Rover-a, makinat më të shtrenjta. Ndaj them që fytyra e shtetit doli lakuriq. Nuk e krahasoj punonjës të emergjencave as me ekipet franceze, holandeze, as me ekipet izraelite, kroate, greke apo as me ekipet kosovare, që erdhën dhe këtë e kam përjetuar përditë, sepse kam qenë i angazhuar në Durrës. Kjo na bënte të gjithëve të ndiheshim keq! E thamë këtë, duke qenë se kryetari kërkoi që pyetjet dhe diskutimet të bëheshin bashkë. Kam një pyetje për buxhetin e vitit 2022, duke qenë se thatë se buxheti i emergjencave është rritur në 53%, janë rritur 2 herë investimet, janë rritur me 33% investimet e huaja, a kemi diçka konkrete? Duke thënë se janë rritur investimet, qytetari që shikon dhe ka hall, thotë: këta flasin për rritje investimesh dhe vetëm për tenderët e vet, dhe zyrtari është i qartë për këtë punë dhe e bën mirë, por problemi shtrohet çfarë do të përfitojë qytetari. Mund të thoni diçka konkrete për investimet që keni shtuar, që në rastin e fatkeqësive natyrore, për shembull, për tërmetin, sepse qytetarët janë të trembur, pra: ne gjatë vitit 2022 do të rregullojmë 3-4 gjëra...

Faleminderit!

Haki Çako – Faleminderit!

I nderuar zoti Xhaferraj,

Nuk besoj se ka të bëjë *Range Rover*-i me qenien sa ditë para tërmetit, por gjithsesi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju mirëkuptoj dhe personalisht nuk jam këtu për të bërë politikë.

Kam shumë respekt për ju dhe e konsideroj si obligim dhe detyrë absolute timen të përgjigjem për çdo pyetje, por sigurisht të mos bëj komente politike.

Më duhet t'ju them se qeveria shqiptare dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile që unë drejtoj, në vitet 2017-2018 ka ndërmarrë një reformë shumë të rëndësishme në sistemin e mbrojtjes civile.

Shqipëria, për hir të së vërtetës, deri në korrik të vitit 2019, kur në këtë komision më është dashur të relatoj ligjin nr. 45 “Për mbrojtjen civile”, kishte një ligj të paabdetuar me interesin dhe nevojën imediate të Shqipërisë për shkak të fatkeqësive natyrore, që e kanë ekspozuar atë prej gati 30 vjetësh tranzicion në një nga vendet më të rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore në Europë dhe në botë. Ky është një fakt. Më pas, faktorët i përkasin një analize më të detajuar, që lidhen me faktorët natyrorë dhe faktorët njerëzorë, që kanë sjellë këto pasoja, që e ekspozojnë Shqipërinë në vendet më kryesore.

Më duhet të them se është e vërtetë që sot jemi me një reformë të avancuar. Ligji nr. 45 “Për mbrojtjen civile” është dakordësuar në bashkëpunim edhe me deputetët e maxhorancës dhe të opozitës, të cilët kanë qenë prezentë në të gjitha komisionet. Unë kam paraqitur jo vetëm nevojën, por edhe risitë që sjell ky ligj. Është e rëndësishme të kuptojmë se emergjencat civile apo mbrojtja civile është një sistem i tërë, jo një strukturë apo një institucion. Për sa kohë që fatkeqësitë natyrore ekspozojnë, bëjnë të dëmtueshëm çdo individ, çdo qytetar, pavarësisht se kujt i përket dhe çfarë dimensioni ka, të gjitha strukturat dhe institucionet janë pjesë e këtij sistemi. Ky sistem tashmë ka filluar të funksionojë.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është institucion i qeverisë shqiptare që merret me politikat, me koordinimin, me bashkëpunimin dhe bashkërendimin e të gjitha institucioneve, të operatorëve apo të subjekteve të ndryshme.

Në këtë kuadër, unë kam për detyrë të referoj sot buxhetin e institucionit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile jo të sistemit të mbrojtjes civile. Buxheti i sistemit të mbrojtjes civile është tërësia e buxheteve që përbëjnë të gjitha institucionet, të gjitha ministritë, i gjithë pushteti vendor, pasi në prioritetin e tyre, në qendër të vëmendjes së tyre, sikurse e ka edhe ligji,

ata kanë strukturat përkatëse të emergjencave civile, të cilët kanë përlllogaritur në përqindjen e vet detyrimet e veta.

Unë jam i qartë për detyrën time. Sigurisht që ky buxhet është i pamjaftueshëm për të finalizuar gjithçka, sikurse e thashë edhe më parë. Detyrimi ynë është mbajtur ndaj të gjithë atyre qytetarëve të ekspozuar nga përmbytjet, nga zjarret, nga tërmetet ndër vite dhe bart detyrimin tim për t'iu përgjigjur hap pas hapi qytetarëve, deri në eliminimin përfundimtar.

Ky proces do kohën dhe financat e veta, që nuk mund të realizohen brenda një dite. Fatkeqësitë natyrore apo emergjencat civile janë procese natyrore që nuk mund të parashikohen. Ne jemi duke diskutuar sot dhe nesër nuk e dimë se çfarë mund të sjellë natyra, por ne jemi duke rritur maksimalisht kapacitetet e emergjencave civile, sidomos Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, duke vendosur një harmonizim, një zinxhir, që të funksionojë nga qendra në bazë, për të qenë në harmoni dhe në funksion të plotë, sikurse edhe sistemet e tjera të mbrojtjes civile në Bashkimin Europian, ku ne kërkojmë të anëtarësohemi së shpejti në mekanizimin e mbrojtjes civile europiane, për të qenë edhe në mënyrë reciproke, për t'iu përgjigjur, sikurse na janë përgjigjur. E vërteta është që partnerët tanë na janë përgjigjur në kohë rekord, si njësitë e shpëtimit.

Ka pasur mangësi dhe jemi duke punuar për kompletimin e të gjitha strukturave operationale për rastet e fatkeqësive natyrore, duke filluar nga Forcat e Armatosura, nga Policia e Shtetit, nga Emergjencia Shëndetësore, nga Zjarrfikëset, Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi. Ka probleme, sepse është e vërtetë që stacionet e mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit kanë mjete të viteve 1950-1960 dhe kjo është nevojë imediate për të rehabilituar të gjithë flotën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit. Ne jemi duke punuar me një program konkret. Kemi specifikuar të gjitha nevojat e tyre dhe shumë shpejt qeveria shqiptare dhe parlamenti shqiptar do të ratifikojë një marrëveshje me qeverinë italiane, e cila do të ngrejë në nivel maksimal të gjitha kapacitetet teknike të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Çako, për paraqitjen!

Faleminderit, zonja Dhembli!

Të nderuar kolegë deputetë,

Mbyllet mbledhja për ditën e sotme.

Faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA